



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqëqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.

**Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore,
Mosdiskriminimit,
të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin
Europian**

Raport vendimmarrjeje

Nr. 5 /Datë 28.01. 2026

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN DHJETOR 2025, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet perkatese.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.3 datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike":

Situata aktuale e funksionit:

Familjet në nevojë që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë të ndihmës ekonomike , janë përzgjedhur nga lista e familjeve që kanë aplikuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit. Kjo listë del në fund të muajit .Administratorët shoqërorë kanë kryer paraprakisht vlerësimin social-ekonomik dhe kanë përzgjedhur familjet që plotësojnë kriteret për tu trajtuar nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera nga administratorët shoqërorë të njësive përkatse, konkludohet dhe propozimet:

Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin DHJETOR 2025 gjithsej 179 familje me fond 737204 leke.

Situata financiare:

Sipas dokumentacionit/relacionit që shoqeron projekt vendimin

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Drejtoria e shërbimeve sociale

Drejtoria Ekonomise dhe menaxhimit financiar

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e shërbimeve sociale

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Qytetare te bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik? Jo.

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise, Mbikëqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural. Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, i mbledhur më datë 28.01. 2026, shqyrtoi projektvendimin **PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË**

KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN DHJETOR 2025. Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
 - b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
 - c- *Refuzimin e miratimit të projektaktit.*
 - d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*
- _____
- _____
- _____

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Mumozë Shuli ; Gëlnuk Hashullari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Anber Hale ; Mumozë Shuli Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 28.01. 2026